

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“SVS Lift Albania” SH.P.K.**

**Neni 1**

**Formimi**

Sot me datë 18.01.2025 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**SVS Lift Albania” SH.P.K.**”

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Valentina Kahveci**, e datëlindjes 15.05.1987, lindur në Tirane dhe banuese në Tirane,

**Neni 2**

**Selia**

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**SVS Lift Albania” SH.P.K.**” është në adresën: **Rruga Astrit Losha, Pallati Marituda, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 300/142, Kati i pare, Dyqani Nr. 15, Kashar, Tiranë.**

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**SVS Lift Albania” SH.P.K.**” është e pacaktuar.

**Neni 4**

**Objekti Veprimtarisë**

1. Tergtimi dhe Montimi i Ashensoreve
2. Tregtimi me shumicë i të gjithë llojeve të materialeve të ndërtimit
3. Tregtimi me pakicë i të gjithë llojeve të materialeve të ndërtimit
4. Importimi dhe eksportimi i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit
5. Të kryejë punime dhe shërbime ndërtimi të çdo lloji
6. Të hapë dhe menaxhojë Hotele, Resorte Turistike, Bar Kafe etj
7. Të hapë dhe menaxhojë agjensi turistike

8. Të operojë në fushën e turizmit
9. Të blejë dhe shesë pasuri të paluajtshme
10. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e pajisjeve elektrike dhe materialeve elektrike.
11. Të importojë, eksportojë dhe të shesë me shumicë dhe pakicë detergjente dhe produkte kozmetike.
12. Të importojë, eksportojë dhe të shesë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e produkteve për dhurata dhe lodrave për fëmijë.
13. Të importojë, eksportojë, prodhojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakice mobilje
14. Të importojë, eksportojë dhe të tregtojë me shumicë dhe pakicë enë kuzhine të të gjitha llojeve.
15. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumice dhe pakicë të gjithë llojet e tekstileve, veshje, veshmbathje, copa etj.
16. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e pajisjeve elektronike.
17. Të importojë, eksportojë dhe tregtojë me shumicë të gjitha llojet e kimikateve dhe të bëjë transportin e tyre me mjetet e veta ose me të tretë për përbushjen e këtij qëllimi.
18. Të transportojë mallrat e tregtuara nga ana e saj me mjetet e veta ose të kontraktuara për përbushjen e aktivitetit të saj.
19. Të kryejë transport brenda dhe jashtë vendit të mallrave të veta dhe të të tretëve me mjetet e veta ose të kontraktuara nga të tretë për përbushjen e këtij qëllimi.
20. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
21. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

## Neni 5

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqerisë “SVS Lift Albania” SH.P.K. është 100.000 (Njeqind mijë) Lekë, i ndarë në 1 kuote si vijon:

1. **Valentina Kahveci** : Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njeqind mijë) Lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 6

### Organet e Shoqërise dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë “SVS Lift Albania” SH.P.K. janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administrator i shoqërisë, është **Znj. Valentina Kahveci**. Shoqëria do të administrohet nga **Znj. Valentina Kahveci**, si administrator i saj, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhieniet me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.



## Neni 7

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

## Neni 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t'a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

## Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të ketij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk jasin rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**SVS Lift Albania**” SH.P.K. në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria “**SVS Lift Albania**” SH.P.K. njihet si person juridik.

## Neni 10

1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortakët e shoqërisë i jasin të drejtën **Znj. Valentina Kahveci**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjeter për regjistrimin e shoqërisë “**SVS Lift Albania**” SH.P.K.

### ORTAKËT THEMELUES I SHOQERISE

**Valentina Kahveci**

*Valentina Kahveci*

*[Handwritten signature]*